

[Gjykata Supreme -duke vendosur mbi Kontestet Ekonomike - vendimi i vërtetuar - ankesa e refuzuar neni 365 LPK neni 14 LPP]

Debitori NPPT "Ardita" nga Gjakova paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë duke mbajtur qëndrim se gjykata kishte shkelur dispozitat e procedurës përmbarese dhe se kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike.

Kreditori me propozim për ekzekutimin e aktvendimit kërkon nga debitori pagesën e borgjit. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë ka lejuar ekzekutimin e vendimit ndaj debitorit për pagesën e detyrueshme të borgjit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se gjykata e shkallës së parë drejt i ka zbatuar dispozitat e procedurës përmbarese kur ka hedhur posht ankesën e debitorit dhe me këtë ka sjell vendim mbi lejimin e ekzekutimit. Gjykata vendosi përkritazi me revizionin e debitorit - të paditurit, të cilin e konsideroj si të pabazuar, për arsye se kushtet e parapara për prishjen e aktvendimit në bazë të nenit 50 nuk janë përmbushur. Pramdaj, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur se ankesa e debitorit është e pabazuar.

En.nr.6/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Meleqe Behxheti, kryetare, Shahdane Agani dhe Osman Tmava, anëtarë, në lëndën e ekzekutimit të kreditorit DOO "Goriziana" nga Cazini të cilën e përfaqëson P.P. nga Gjakova, kundër debitorit NPPT "Ardita" në Gjakovë, për shkak të borxhit në shumë prej 90.948,66 €, përkritazi me ankesën e debitorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë E.nr.57/2005 datë 18.05.2005, në seancën e mbajtur më 29.7.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit dhe vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë E.nr.57/2005 datë 18.05.2005.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë E.nr.57/2005 datë 18.05.2005, është refuzuar si e pabazuar prapësimi i debitorit i paraqitur kundër aktvendimit mbi lejimin e përbarimit E.nr.57/2005 datë 27.04.2005.

Kundër aktvendimit, me të cilin është refuzuar prapësimi, debitori ka paraqitur ankesë në afatin ligjor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës së përbarimit, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i goditur të ç'fuqizohet dhe të ndërpehen të gjitha veprimet e ndërmarrura procedurale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 365 të LPK, lidhur me nenin 14 të Ligjit të Procedurës së Përbarimit (LPP), gjeti se ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se, sipas propozimit të kreditorit, gjykata e shkallës së parë, në bazë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë C.nr.238/2002 datë 09.04.2003, ka lejuar përbarimin kundër debitorit për pagimin e dhunshëm të kërkesës në të holla, në emër të borxhit kryesor në shumën prej 90.498,66 €, me kamatë prej 3% në vit duke filluar prej 04.12.2002 e gjer në pagesën definitive dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 1040 €, me kalimin e mjeteve nga xhirollogaria e debitorit pranë BPK-Gjakovë në xhirollogarinë e kreditorit pranë BpB-Prishtinë ose sekustrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit. Në këtë çështje kontestimore Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas revizionit e të paditurës-kundër paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae.nr.44/2003 datë 10.07.2003, me aktgjykimin Rev.E.nr.3/2004 datë 16.11.2004, ka refuzuar si të pabazuar revizionin e të paditurës kundër paditëses.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e procedurës së përbarimit, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit, paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është lejuar përbarimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar si të pabazuara thëniet ankimore se kreditori është person juridik i huaj për të cilin gjykata nuk mund të vendosë, për arsye se përmbarimi është caktuar në bazë të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë datë 09.04.2003. Përveç kësaj në këtë çështje kontestimore është vendosur edhe sipas revizionit të debitorit të paditurës i cili është refuzuar si i pabazuar, ashtu që nuk janë plotësuar kushtet nga neni 50 të LPP, për paraqitjen e prapësimit kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit.

Debitori me asnjë provë nuk e ka sjellë në dyshim ligjshmërinë e aktvendimit të goditur.

Në bazë të asaj që u tha me zbatimin e nenit 380 pika 2, 381 të LPK, lidhur me nenin 14 të LPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
En.nr.6/2005, më 29.07.2005

Kryetare e kolegjit,
Meleqe Behxheti

[Gjykata Supreme -duke vendosur mbi Kontestet Ekonomike ankesa e refuzuar pasurimi pabazë konflikt kompetencash jurisdikcioni avsolut i gjykatës - neni 26 LGJR - neni 55 Ligji mbi Zgjidhjen e Konflikteve të Ligjeve neni 16 pika 2 LPK]

Paditësi parashtrij ankesë në Gjykatën Komunale në Klinë për pasurim e pabazë të paditurit në shumë prej 110.000 DM.

Gjykata Komunale në Klinë u deklarua si jokompetente duke mos patur kompetencë lëndore, duke gjetur se Gjykata kompetente për të vendosur mbi kontestin është Gjykata e Qarkut në Prishtinë e cila gjithashtu u deklarua si jokompetente, duke gjetur se Gjykata kompetente për të vendosur mbi kontestin është Gjykata Ekonomike në Prishtinë, e cila Gjykatë gjithashtu rrefuzoi kompetencën lëndore mbi çështjen duke u shpallur si jokompetente, me arsyetimin se në bazë të neni 26 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, gjykata kompetente për të vendosur mbi këtë çështje është Gjykata Komunale e Klinës, duke ja referuar rastin Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme ka vendosur se Gjykata e shkallës së parë është e obliguar ex officio të vërtetojë kompetencat e saja në bazë të nenit 16 pikës 2 të LPK dhe të deklarojë si jokompetente, pa kompetencë lëndore, dhe të refuzoj ankesën. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në bazë të dispozitës së lartpërmendur. Prandaj Gjykata Supreme ka refuzuar ankesën e paditësit.

EN.nr.8/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të paditësit B.E., nga Gjurgjeviku i Vogël, komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson Xhafer Maloku, avokat nga Klina, kundër të paditurës H.Burgstaller GMBH A-4680 Haag Am Hausruck Bahnhofstrasse 26, Republika e Austrisë, për pasurimin pabazë, me rastin e konfliktit të kompetencës ndërmjet Gjykatës Komunale Klinë dhe Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, në seancën e mbajtur më 19.08.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia e paditëses.

A r s y e t i m i

Me padinë e paraqitur në Gjykatën Komunale Klinë, paditësi kërkon në emër të pasurimit të pabazë shumë prej 110.000 DM.

Gjykata Komunale Klinë, me aktvendimin C.nr.132/2002 datë 23.02.2005, është shpallur jokompetente lëndore për ta zgjidhur këtë kontest, duke gjetur se për këtë është kompetente Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë.

Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë nuk e ka pranuar kompetencën lëndore lidhur me zgjidhjen e këtij kontesti, me arsyetim se, sipas nenit 26 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, kompetente është Gjykata Komunale Klinë, prandaj lëndën ia ka dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës që, sipas nenit 22 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), të zgjidhë këtë konflikt kompetence.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se zgjidhja e këtij kontesti nuk bie në juridiksionin e gjykatave.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi me padi paraqitur në Gjykatën Komunale Klinë, kërkon në emër të pasurimit pa bazë shumë prej 110.000 DM. Gjykata Komunale Klinë shpallet jo kompetente lëndore për ta zgjidhur këtë kontest, duke gjetur se për këtë është kompetente Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë. Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë nuk e ka pranuar kompetencën lëndore me arsyetim se, sipas nenit 26 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, kompetente është Gjykata Komunale Klinë, prandaj lëndën ia ka dërguar Gjykatës Supreme të Kosovës që të zgjidhë këtë konflikt kompetence.

Sipas nenit 55 të Ligjit mbi Zgjidhjen e Konfliktit të Ligjeve me Dispozitat e Vendeve të Tjera në Marrëdhënie të caktuara ("Gazeta zyrtare e RSFJ nr.43/1982) parashikohet se në kontestet kundër personave fizikë dhe juridikë të cilët e kanë selinë jashtë vendit, për obligimet që kanë lindur në RSFJ, apo të cilat duhet të përmbushen në territorin e RSFJ mund të ushtrohet padi pranë gjykatës në këtë territor, nëse ky person ka në territorin e RSFJ përfaqësinë e tij apo nëse në RSFJ

është selia e Organizatës së Punës së Bashkuar të cilës i është besuar kryerja e punëve të tyre. Në rastin konkret paditësja nuk e ka provuar faktin se e paditura e ka përfaqësinë e saj në territorin e Kosovës apo nëse në Kosovë është selia e Organizatës së Punës së Bashkuar të cilës i është besuar kryerja e punëve të tyre.

Gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që, sipas detyrës zyrtare, të kujdeset për kompetencën gjyqësore me zbatimin e nenit 16 par.2 të LPK dhe të shpallet jo kompetente, t'i abrogojë veprimet e zbatuara në procedurë, dhe ta hedhë poshtë padinë.

Ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas dispozitës së lartpërmendur, Gjykata Supreme u desh që me zbatimin e nenit 16 par.2 të LPK, padinë e paditëses ta hedhë poshtë.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË

En.nr.8/2005, më 19.09.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani

[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi Kontestet Ekonomike procedura e përmbarrimit - ankesa e pranuar neni 365 LPK - neni 381 LPK - neni 20 LPP]

Debitori KBI "Kosova-Export" BPPP nga Fushë Kosova paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë mbajtur qëndrim se gjykata kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike.

Gjykata Ekonomike ka rrefuzuar kërkesën e debitorit kundër aktvendimit për ekzekutim.

Gjykata Supreme ka vendosur se Vendimi mbi Përmbarrim është i përshtatshëm për përmbarrim nëse ai i përmban detajet e Kreditorit dhe Debitorit, lëndën, kompetencën dhe afatin kohor për përmbarrjen e obligimit në bazë të nenit 20 të LPP. Gjykata Supreme ka vendosur se lejimi i ekzekutimit ndaj personit tjetër fizik ose juridik, e jo ndaj debitorit i cili është i shënuar në titullin përmbarrimor, mund të lejohet vetëm atëherë kur në dokumente publike ose në dokumente të verifikuara publikisht, ka dëshmi që përgjegjësjë përkatëse ka kaluar në ndonjë individ ose person juridik tjetër. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e debitorit është e pabazuar.

Ae.nr.60/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shahdane Agani, kryetare, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, në çështjen juridike të përmbarrimit të kreditorit NSH Fabrika e Ushqimit të Kafshëve, në Fushë Kosovë, kundër debitorit "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, me bashkimin e punës dhe mjeteve me BPPP të KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë, përkritazi me ankesën e debitorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.192/2003 datë 26.05.2005, në seancën e mbajtur më 10.08.2005, mori këtë

A K T V E N D I M

Pranohet ankesa e debitorit NSH KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë dhe prishet aktvendimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut

Prishtinë, E.nr.192/2003 datë 26.05.2005, ndërsa lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.192/2003 datë 26.05.2005, është refuzuar kundërshtimi i debitorit Ferma e Derrave në Miradi të Epërme pranë BPPP të KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë, paraqitur kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarrimit, E.nr.192/2003 datë 18.12.2003.

Kundër aktvendimit të goditur debitori KBI "Kosova-Export" BPPP në Fushë Kosovë me kohë ka paraqitur ankesë duke cekur se edhe pse sipas aktit normativ-marrëveshja mbi bashkimin e punës, gjashtë ndërmarrje shoqërore kanë nënshkruar se e bashkojnë punën nën kompleksin e Agro-Kombinatit "Kosova-Export" në Fushë Kosovë, në mesin e të cilave janë edhe NSH "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme dhe NSH "FUB" në Fushë Kosovë, por ato kanë qenë dhe se janë subjekt të pavarur juridikë, janë të regjistruara si të tilla dhe kanë xhirollogaritë e veta, prandaj nuk mund të pranojë borxhin kontestues.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 365 lidhur me nenin 381 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), Gjykata Supreme ka gjetur se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës del kreditori në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.83/2001 datë 15.10.2001, ka bërë propozimin për lejimin e përmbarrimit. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin E.nr.192/2003 datë 18.12.2003, ka lejuar përmbarrimin kundër debitorit "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë. Kundër aktvendimit të lartpërmendur debitorit KBI "Kosova-Export" BPPP në Fushë Kosovë ka paraqitur kundërshtim me arsyetimin se NSH "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme është subjekt i pavarur juridik me përgjegjësi të plotë, prandaj N.SH. KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë si ndërmarrje e përbërë shoqërore në kuadër të së cilës veprojnë edhe kreditori N.SH. Fabrika e ushqimit të kafshëve në Fushë Kosovë edhe debitori N.SH. "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, nuk i bart përgjegjësitë e as detyrimet të asnjërës në kontest.

Me nenin 20 të Ligjit për Përmbarrim, parashikohet se dokumenti i përmbarrimit është i përshtatshëm për përmbarrim nëse në të janë shënuar kreditori dhe debitori, si dhe lënda e objektit, lloji, vëllimi dhe koha e përmbarrjes së detyrimit.

Nga aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.83/2001 datë 15.10.2001, del se e paditura NP "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, komuna e Fushë Kosovës, është e detyruar që paditëses NP Fabrika e ushqimit të kafshëve KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë, në emër të borxhit t'ia paguajë shumën prej 49.830,50 DM, me kamatë ligjore duke filluar prej 20.09.1999 deri në pagesën definitive si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 278 DM. Kreditori në propozimin për lejimin e përmbarrimit e ka shënuar si debitor N.SH. "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, me bashkimin e punës dhe mjeteve me BPPP KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë, dhe me aktvendimin për lejimin e përmbarrimit të asaj gjykate E.nr.192/2003 datë 18.12.2003, është lejuar përmbarrimi dhe është detyruar debitori N.SH. "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë. Me aktvendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, E.nr.192/2003 datë 25.05.2005, urdhërohet Bankës së Re të Kosovës në Prishtinë, që në emër të borxhit të përcaktuar në aktvendimin e lejimit të ekzekutimit E.nr.192/2003 datë 18.12.2003, nga llogaria e debitorit "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, pranë BPPP KBI "Kosova-Export" në Fushë Kosovë të bartë në llogari të kreditorit shumën prej 25.477,93 € në emër të borxhit kryesor, me kamatë ligjore prej 20.09.1999 dhe shumën prej 189 € në emër të shpenzimeve të procedurës të ekzekutimit. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin E.nr.192/2003 datë 26.05.2005, e ka refuzuar si të pabazuar kundërshtimin e debitorit, me arsyetimin se: "Me vendimin nr.21/2 i datës 21.02.2000, në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin e punës NSH KBI "Kosova-Export" nga Fushë Kosova NSH ferma për majmëri në Miradi të Epërme është nën menaxhment dhe kontroll direkt të drejtorisë KBI "Kosova-Export" nga Fushë Kosova, prandaj me këtë marrëveshjes NSH KBI "Kosova-Export" i ka marrë edhe të gjitha obligimet e fermës për majmëri - në rastin konkret të debitorit.

Por, lejimi i përmbarrimit kundër personit tjetër dhe jo kundër atij që në titullin përmbarrues është përmendur si debitor mund të jepet vetëm nëse me dokumente publike ose me dokumentet publikisht të vërtetuara provohet se detyrimi i përcaktuar në titullin përmbarrues ka

kaluar te ky personi tjetër.

Pa lejen e përmbarrimit ndaj personit tjetër, përmbarrimi mbi pasurinë e tij nuk mund të zbatohet në bazë të lejes ndaj personit të përcaktuar në titullin përmbarrues, pa marrë parasysh që me dokument publik ose me dokument publikisht të vërtetuar është provuar se detyrimi i përcaktuar në titullin përmbarrues ka kaluar te ky personi tjetër.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar t'i mënjanojë të metat e cekura, të vërtetojë se NSH "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, a është e regjistruar si person juridik, a ka xhirrologarinë e vet, apo është e regjistruar si "Ferma e derrave" në Miradi të Epërme, pranë BPPP të KBI "Kosova-Export" në fushë Kosovë, si një person juridik, me një xhirrologari, dhe me administrimin e provave, t'i vërtetojë të gjitha faktet vendimtare, të vlefshme për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike, duke pasur parasysh edhe thëniet e ankesës dhe, pas vlerësimit të drejtë të provave, të marrë një vendim të ligjshëm.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 380 pika 3 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, PRISHTINË
Ae.nr.60/2005, më 10.08.2005

Kryetare e kolegjit,
Shahdane Agani